



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

Elbasan me date 18.01.2022

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE
NGRITJE NË DETYRË
NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE**

Në zbatim të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, nenet 25,26; Kreut II dhe III të VKM nr. 242, date 18.03.2015 “Per plotesimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”; Këshilli i Qarkut Elbasan, shpall procedurën e lëvizjes paralele/ ngritje në detyrë, për pozicionin:

Shef i Sektorit të Financë/Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbeshtetëse në Këshillin e Qarkut Elbasan. Kategoria: III-a/1

Lloji i diplomës: Shkencat ekonomike; Dega: Finance-Kontabilitet

Niveli minimal i diplomës “ Master Shkencor”

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, NGRITJE NË DETYRË) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE:	28 Janar 2022
Afati për dorëzimin e dokumentave për NGRITJE NË DETYRË:	02 Shkurt 2022

Qellimi i përgjithshëm i pozicionit të punës:

- Garantimi i cilësisë së dokumentit përfundimtar të buxhetit dhe bashkërendimit të punës gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit të Këshillit të Qarkut, në rolin e sekretarit të grupit të menaxhimit strategjik.
- Raportimi periodik për vendimmarrjen, në funksion të realizimit të objektivave lidhur me pjesën e të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara, si dhe të Pasqyrave Financiare vjetore të institucionit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe rregullat e miratuara nga Ministra e Financave
- Mbështetja e Nëpunësit Autorizues, në lidhje me ngritjen dhe zbatimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit
- Garantimi para miratimit të shkresave/urdrave me karakter financiar, lidhur me ligjshmërinë, rregullshmërinë dhe respektimin e parimeve të ekonomicitetit, eficensës dhe efektivitetit.
- Monitorimi i procedurave të burimeve njerëzore në lidhje me strukturën, punësimet, pagat, vlerësimet, trajnimet.

- Përgatitja dhe monitorimi i regjistrimit të prokurimit në bashkëpunim me sektorët për sigurimin dhe furnizimin në kohë me materiale dhe shërbime sipas planit të aktiviteteve.

1 - Levizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.1. Kushtet per levizjen paralele

- Te jete nepunes civil i konfirmuar brenda se njejtës kategori, ne pozicionin shëf/pergjegjes ne sektorin e finances (kategoria e pages III-a/1)
- Te mos kete mase disiplinore ne fuqi.
- Te kete te pakten vlerësimin e fundit “Mire”apo “Shume mire”

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të zotërojnë një diplomë të nivelit "Master Shkencor"/ në Shkenca Ekonomike, dega finance kontabilitet edhe diploma e nivelit "Bachelor" duhet të jetë në të njëjtën fushë;
- Të kenë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në profesion;
- Te njohë dhe te perdore shume mire programet kryesore; Word, Exel, programin Financa 5; Kontabilitet-Alfa.
- Te kete njohuri te mire te gjuhes angleze

1.2. Dokumentacioni, menyra dhe afati i dorezimit.

Kandidatet duhet te dorezojne me poste ose dorazi ne zyren e Burimeve Njerezore, prane Keshillit te Qarkut Elbasan keto dokumenta:

- Jetëshkrim Standart (C-V)
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor), (nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit);
- Fotokopje e listës së notave (nëse ka një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)/çertifikate familjare.
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetedeklarim te gjendjes gjyqesore.
- Aktin e emerimit si nepunes civil.
- Aktin e Konfirmimit si nepunes civil.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

1.3. Rezultatet per fazen e verifikimit paraprak.

Në datën 31/01/2022 , Sektori i Finance/Burimeve Njerezore do të shpallë në faqen zyrtare të internetit dhe në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Sektori i Finance/Burimeve Njerezore për shkaqet e moskualifikimit (nëpërmjet adresës së e-mail).

1.4. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilesitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

Njohuri mbi Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;

Njohuri mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015;

Njohuri mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.08.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 57 datë 02.06.2016;

Njohuri mbi Ligjin i nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014;

Njohuri mbi Ligjin nr. 131, datë 09.08.2003, “Mbi rregullat e etikës në Administratën Publike”;

Njohuri mbi Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

1.5. Menyra e vleresimit të kandidatëve

Kandidat do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vleresimet pozitive.

Totali i pikeve për këtë vlerësim është **40 pike**.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a - Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;

b - Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c - Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

Totali i pikëve për këtë vlerësim është **60 pikë**.

Ne perfundim të vleresimit të kandidatëve, sektori i burimeve njerezore do të shpallë fituesin në portalin “Sherbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare dhe në stenden e informimit të publikut.

2 – NGRITJA NE DETYRE

Vetem në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në perfundim të procedurës levizje paralele, rezulton se ende është vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë vetëm nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin institucion apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet për ngritjen në detyrë dhe kërkesat e veçanta për vendin e lirë.

2.1 Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Te zotërojnë diplome të nivelit “Master Shkencor”/ne Shkencat Ekonomike, dega Finance-Kontabilitet dhe diploma e nivelit Bachelor duhet të jete në të njëjtën fushë. (*diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jene të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehesimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi*)
- Te jete nëpunës civil i konfirmuar në pozicionin e specialistit të financës.
- Te mos ketë masa disiplinore në fuqi (te vertetuar me dokument nga institucioni)
- Te ketë të paktën vlerësimin e fundit “Mire” apo “Shume mire”
- Te ketë mbi 5 vjet pune në profesion.

- Te njohje dhe te perdore shume mire programet kryesore; Word, Exel, programin Financa 5; Kontabilitet-Alfa.
- Te kete njohuri te mire te gjuhes angleze.

2.2 DOKUMENTACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatet qe do te aplikojne duhet te dorezojne dokumentat si me poshte:

- Jeteshkrim Standart (C-V)
- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor), (nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, duhet ta ketë të njësuar pranë Ministrisë së Arsimit);
- Fotokopje e listës së notave (nëse ka një listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar);
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vetedeklarim te gjendjes gjyqesore.
- Aktin e emerimit si nepunes civil.
- Aktin e Konfirmimit si nepunes civil.
- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- Aktin e emerimit si nepunes civil/kategoria ekzekutive.
- Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnime/kualifikimet/arsim shtesë ne fushesn e finances; vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

2.3 REZULTATET PER FAZEN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Ne daten 04.02.2022 Sektori i Finance/Burimeve Njerezore do te shpalle ne portalin “Sherbimi Kombetar i Punesimit, ne faqen zyrtare, listen e kandidateve, qe plotesojne kushtet dhe kriteret e vecanta per proceduren e ngritjes ne detyre, vendin, daten dhe oren ku do te zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me goje. Ne te njejten date kandidatet qe nuk plotesojne kushtet dhe kriteret e vecanta per proceduren e ngritjes ne detyre do te njoftohen individualisht ne menyre elektronike, per shkaqet e moskualifikimit.

2.4 Fushat e njohurive, aftesite dhe cilesite mbi te cilat do te zhvillohet testimi dhe intervista.

Kandidatet do te testohen me shkrim ne lidhje me:

Njohuri mbi Ligjin nr. 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;

Njohuri mbi Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015;

Njohuri mbi Ligjin nr. 9936, datë 26.08.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 57 datë 02.06.2016;

Njohuri mbi Ligjin i nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014;

Njohuri mbi Ligjin nr. 131, datë 09.08.2003, “Mbi rregullat e etikës në Administratën Publike”;

Njohuri mbi Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

Kandidatet gjate intervistes se strukturuar me goje do te vleresohen ne lidhje me:

- Njohurite, aftesite, kompetencen ne lidhje me pershkrimin e pozicionit te punes,
- Eksperiencen e tyre te meparshme,
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmerite e tyre per karrieren.

2.5 Menyra e vleresimit ne lidhje me:

- Jeteshkrimin, qe konsiston ne vleresimin e arsimimit, te pervojes se trajnimeve, te lidhura me fushen, deri 20 pike.
- Vleresimi me shkrim, deri ne 40 pike;
- Intervisten e strukturuar me goje deri ne 40 pike

2.6 Data e daljes se rezultateve te konkurimit dhe menyra e komunikimit.

Ne perfundim te vleresimit te kandidateve, sektori i burimeve njerezore do ti njoftoje ata individualisht ne menyre elektronike per rezultatet (*nepermjet adresese se e-mail, apo nr.telefonit*) dhe do te shpalle fituesin ne portalin “Sherbimi Kombetar i Punesimit” dhe ne faqen zyrtare te institucionit.